

Në mbështetje të nenit 17. dhe nenit 21. të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-111 dhe Ligji Nr.05/L-009, Komisioni i Auditimit i KRU "Hidromorava"-SH.A. Gjilan, me datë 31.07.2024, nxjerr këtë;

V E N D I M
Për anulim të konkursit publik

Anullohet Konkursi Publik Nr.673 i shpallur me datë 10.06.2024, për pozitën Zyrtar i Auditimit të Brendshëm në KRU "Hidromorava"- SH.A. Gjilan.

A r s y e t i m

Komisioni i Auditimit i Kompanisë Rajonale të Ujësjetjesit "Hidromorava" -SH.A. në Gjilan, me rastin e shpalljes së Konkursit Publik Nr.673 të dt. 10.06.2024 për plotësimin e pozitës punuese Zyrtar i Auditimit të Brendshëm në KRU "Hidromorava"-SH.A. pas administrimit dhe shqyrtimit të aplikacioneve të kandidatëve në pajtim me nenin 17. dhe 21. të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, me ndryshim plotësim nga Ligji Nr. 04/L-111 dhe Ligji nr.05/L-009, konstatoi se asnjëri nga kandidatët të cilët kanë aplikuar për këtë pozitë nuk i kanë plotësuar kriteret sipas konkursit të publikuar konform dispozitave të Ligjit për Ndërmarrjet Publike.

Nga të cekurat si më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Obligohet Sekretarja e Ndërmarrjes që të njoftoj NJPMNP si dhe kandidatët që kanë aplikuar për pozitën e Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm dhe i njehti vendim të publikohet në web-faqe të Ndërmarrjes.



Kryesuesja e Komisionit të Auditimit,
Ferdane Tahiri Sylejmani
(znj. Ferdane Tahiri Sylejmani)